

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18) dhe 208/24, duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Qendra Diagnostike Vila Bogatin d.o.o., me seli në Pod Skalo 4, 4260, Bled, Slloveni, dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Knezoviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 18.10.2024, mori këtë

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Qendra Diagnostike Vila Bogatin d.o.o., me seli në Pod Skalo 4, 4260, Bled, Slloveni, synon të fitojë kontrollin mbi PULMED, ambulancë për sëmundje pulmonare dhe alergjike, d.o.o., me seli në Seidlova cesta 46, 8000 Novo mesto, Slloveni, përmes blerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë Administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6,000.00 denarë dhe për vendimin në shumën prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840..03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për iniciimin e kontestit Administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 20.09.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i është dorëzuar njoftimi për përqendrim nga Qendra Diagnostike Vila Bogatin d.o.o., me seli në Pod Skalo 4, 4260, Bled, Slloveni, me të cilin Qendra Diagnostike Vila Bogatin d.o.o., synon të fitojë kontrollin mbi PULMED, ambulancë për sëmundje pulmonare dhe alergjike, d.o.o., me seli në Seidlova cesta 46, 8000 Novo mesto, Slloveni, përmes blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Qendra Diagnostike Vila Bogatin d.o.o., është themeluar në vitin 1992 dhe është qendra e parë diagnostike në Slloveni. Në fillim, aktiviteti i saj kryesor ishte gastroenterologjia; në vitet që pasuan, gama e aktiviteteve të saj u zgjerua dhe sot ka njësi në Bled, Lubjanë dhe Novo mesto.

Qendra Diagnostike Vila Bogatin u ofron pacientëve klinikat e mëposhtme mjekësore: gastroenterologji, urologji, kardiologji, ortopedi, rrezet X dhe ultratinguj, alergologji, tireologji, klinikë për osteoporozë, dermatologji, gjinekologji, konsultime për ushqyerje.

Qendra Diagnostike Vila Bogatin nuk ka shoqëri të lidhura me seli jashtë Sllovenisë.

Ortakët e drejtpërdrejtë të Qendrës Diagnostike Vila Bogatin janë:

- Pozavarovalnica Sava d.d., Dunajska Cesta 56, 1000 Lubjanë dhe

-Zavarovalnica Triglav d.d., Mikloshiçeva cesta 19, 1000 Lubjanë, Slloveni,

secila me 40% pjesëmarrje në kapitalin themeltar të DCVB dhe kështu do të fitojnë kontroll indirekt mbi Shoqërinë e Synuar.

Pozavarovalnica Sava është shoqëria përfundimtare mëmë e Grupit Sava Osiguranje.

Grupi Sava Osiguranje aktualisht ka katër shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

- Sava Osiguruvanje SHA Shkup me NUAS 4778529 me veprimtari prioritare sigurimin jo-jetë,
- Sava Penzisko drushtvo SHA Shkup me NUAS 5989434 me veprimtari prioritare administrimin e fondeve,
- Sava Stejshn SHPKNJP Shkup me NUAS 7005350 me veprimtari prioritare testimin dhe analizën teknike dhe
- VITA S HOLDING SHPK Shkup me NUAS 7690088 me veprimtari prioritare tregtinë e pa-specializuar me shumicë.

Zavarovalnica Triglav është shoqëria përfundimtare mëmë e Grupit Triglav.

Grupi Triglav aktualisht ka katër shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

Triglav Osiguruvanje SHA Shkup me NUAS 4691130 me veprimtari prioritare sigurimin jo-jetë,

Triglav Osiguruvanje ZHivot SHA Shkup me NUAS 7233825 me veprimtari prioritare sigurimin e jetës,

Triglav penzisko drushtvo SHA Shkup me NUAS 7344228 me veprimtari prioritare SHAdministrimin e fondeve dhe

TRIGLAV upravljanje so nedvižen imot SHPKNJP Shkup me NUAS 7729014 me veprimtari prioritare dhënieën me qira dhe Administrimin e pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira (lizing).

PULMED, ambulancë për sëmundje pulmonare dhe alergjike, d.o.o., është ofrues i shërbimeve shëndetësore në rrjetin e shërbimeve publike shëndetësore në Slloveni. PULMED ofron ekzaminime të gjithanshme pulmonare dhe trajtime të sëmundjeve të mushkërive dhe alergjive.

PULMED, ambulancë për sëmundje pulmonare dhe alergjike, d.o.o., nuk ka shoqëri të lidhura me seli jashtë Sllovenisë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска